



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:298427

Datë: 18.12.2024

Numri i dokumentit: 06617259

C.nr.3117/2024

GJYKATA THEMELORE NË MIROVICË, si kontestimore, me Gjyqtarin Blerim Istrefi, në çështjen juridike të paditësit N.A. nga Mitrovica, përfaqësuar nga Sheremet Ademi av. dhe Leutrim Ademi av me seli në Mitrovicë, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore –DKA, Objekti i Kontestit: Për kompensimin e të ardhurave personale, jashtë seance me dt. 18.12.2024 nxjerr këtë;

A K T V E N D I M

Padia e paditësit N.A. nga Mitrovica, e parashtruar në këtë gjykatë me dt. 24.09.2024, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore –DKA, Objekti i Kontestit: Për kompensimin e të ardhurave personale , **KONSIDEROHET E TËRHEQUR**.

A r s y e t i m

Paditësi N.A., përmes të autorizuarit, ka ushtruar padi me dt. 24.09.2024, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore –DKA, Objekti i Kontesti: Për kompensimin e të ardhurave personale .

Gjykata, me aktvendimin e dt. 10.12.2024, të pranuar nga i autorizuari i paditëses me dt: 11.12.2024, ka kërkuar nga paditësja që brenda afatit 3 ditor ta plotësoj- precizoj padinë, me paralajmërimin konform nenit 99 dhe 102 te LPK-së.

Nga shkresat e lëndës, konstatohet se paditësja nuk ka vepruar brenda afatit të përcaktuar nga gjykata për plotësimin- precizin e padisë, andaj gjykata duke u bazuar në nenin 102.par 3 të LPK-së, padinë e paditësit Nexhmedin Abazi nga Mitrovica, e parashtruar në këtë gjykatë me dt. 24.09.2024, ndaj të paditurës Komuna e Mitrovicës Jugore –DKA, Për kompensimin e të ardhurave personale , e **KONSIDEROJ TË TËRHEQUR**.

Andaj nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv te këtij aktvendimi e në vështrim të nenit 102.par 3 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
C.nr.3117/2024 me dt.18.12.2024

GJYQTARI
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi është e lejuar e drejta në ankesë në afatin prej 7 ditësh prej ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes kësaj Gjykate.